



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 30, datë 31/05/2004

**“PËR
VËNIE EMRI SHKOLLËS 8 – VJEÇARE SELITË DHE NDRYSHIM
EMRI SHKOLLËS 8 – VJEÇARE “MURAT TOPTANI”.**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” neni 32, gërma “II”, ligjit Nr.7652, dt.21.07.1995 “Për sistemin parauniversitar”, neni 55/3, pas shqyrtimit të relacionit të përgatitur nga Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore (Sektori i Politikave Arsimore), me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak i qytetit të Tiranës i mbledhur në datën 31.05.2004, “Për vënie emri shkollës 8 – vjeçare Selitë dhe ndryshim emri shkollës 8 – vjeçare “Murat Toptani”,

V E N D O S I;

1. T'i vërë emrin “Murat Toptani” shkollës 8 – vjeçare Selitë dhe emrin “Ibrahim Brahja” shkollës 8 – vjeçare “Murat Toptani”.
2. Shfuqizimin e vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.25, dt.30.07.2003, pika 3, “Për vënien e emrit “Murat Toptani” shkollës 8 – vjeçare Sauk Poshtë”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Njerëzore (Sektori i Politikave Arsimore), Drejtoria Arsimore e qytetit Tiranë dhe Drejtoria e shkollës 8 – vjeçare për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R I

LUAN SHAHOLLARI